



Para-lajmërim i Ftesës për Aplikim në Roundin e 9-të, të Skemës së Celulës së të Rinjëve, Programi i BE-së për bursa post-diplomike 2012

NB: Ky është një para-lajmërim për të informuar lidhur me hapjen e ardhshme të ftesës për aplikim. Tani nuk kërkohet asnjë veprim nga aplikantët potencial.

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë dhe **Ministria për Integritet Evropian**, paralajmërojnë hapjen e konkursit për Raundin e 9-të, të aplikimit për Skemën e Celulës së të Rinjëve, programi i BE-së për bursa post-diplomike për Kosovën, program i cili aktualisht është duke u zbatuar nga British Council. Aplikimi do të jetë i hapur nga **13 Janar 2012**, deri më **28 Shkurt 2012** dhe kandidatëve të suksesshëm do t'iu ofrohet mundësia të aplikojnë për Programe Master në univerzitetet të shteteve anëtare të BE-së. Programi i Bursave, **gjuha e punës e së cilët është vetëm gjuha Angleze**, do të ofroj deri në 25 bursa të plota (numri real i bursave të ofruara mund të jetë më i vogël varësisht nga përshtatshmëria e kandidatëve dhe fondet në dispozicion). Kjo ftesë do të jetë e hapur për studentët e diplomuar në fakultetet si juridik, ekonomik, menaxhment i biznesit, shkencë politike dhe fusha të tjera akademike (siç është specifikuar në Rregullat e Procedurës që do të publikohen më 13 janar 2012) në përputhje me sektorët e specializimit në vijim:

- ◇ Legjislacioni i BE-së
- ◇ Çështje Evropiane dhe Politika Publike
- ◇ Ekonomi dhe Financa Publike

Të drejtë konkurimi kanë aplikantët të cilët:

- ◇ Posedojnë letërnjoftim dhe/apo Dokument të Udhëtimit të UNMIK-ut ose ata të cilët ofrojnë dëshmitë e lindjes dhe të vendbanimit në Kosovë dhe ata me letërnjoftime dhe me pasaporta të lëshuara nga Autoritetet Kosovare.
- ◇ Të diplomuarit në njërin nga fushat e lartpërmendura të studimeve. Studentët të cilët janë në përfundim të fakultetit poashtu mund të kenë të drejtë **konkurimi nëse marrin diplomën jo më vonë se 30 qershor 2012**.
- ◇ Flasin rrjedhshëm gjuhën Angleze dhe Shqipe apo Serbe. Njohja e gjuhëve tjera të BE-së konsiderohet përparsi.
- ◇ Janë të gatshëm të udhëtojnë dhe të lëvizin jashtë vendit nga Shtatori 2012, dhe të vijojnë trajnime intenzive nga mesi i Prillit 2012.
- ◇ Janë lindur më **29 Shkurt 1972** apo më vonë

Bursat do të mbulojnë shpenzimet për deri në **25 bursistë**, si në vijm:

- ◇ Shpenzimet e shkollimit
- ◇ Shpenzimet e jetesës
- ◇ Shpenzimet e vizës
- ◇ Sigurimin shëndetësorë
- ◇ Biletat e udhëtimit
- ◇ Testin e gjuhës Angleze IELTS (dhe testin GMAT nëse është e nevojshme)

Pjesëmarrësit e përgjedorur do të zotohen të:

- ◇ Punojnë për Administratën Publike të Kosovës si praktikant për së paku dy muaj para nisjes
- ◇ Ndjekin Programin e Trajnimit të Gjuhës SCR (ku është e nevojshme)
- ◇ Ndjekin dhe kryejnë studimet e zgjedhura post-diplomike
- ◇ Përbushin obligimin e punësimit të pandërprerë trevjeçar në Administratën Publike të Kosovës (përfshirë punësimin nëpër komuna dhe qeveri lokale), pas kthimit (kushtet e punësimit do të përcaktohen në kontratë të cilën kandidatët do ta nënshkruajnë para se të nisen) .

Përzgjedhja do të zhvillohet në tri faza dhe përfshinë:

- ◇ Para-përzgjedhja bazuar në kriteret administrative dhe të përzgjedhshmërisë
- ◇ Testet me shkrim (i njohjes së gjuhës Angleze, njohjes së përgjithshme për BE-në, dhe vlerësimi verbal & numerik)
- ◇ Intervistë nga paneli i akademikëve evropianë dhe përfaqësuesve nga KE dhe të MIE

Femrat dhe përfaqësuesit e minoriteteve fuqimisht inkurajohen të aplikojnë. Formularët e aplikimit dhe dokumentet tjera përcjellëse do të jenë të disponueshme për shkarkim nga interneti, në web faqen vijuese www.ycskosovo.eu duke filluar nga **13 Janar 2012**. Informatat shtesë mbi Rregullat e Skemës, Procedurat dhe Kriteret e përzgjedhjes poashtu do të jenë online nga data e njejtë.

Ky është vetëm para-lajmërim për të informuar aplikantët potencial për hapjen e ardhshme të ftesës për aplikim. Aplikimi ende nuk është hapur.

Për më shumë informata www.ycskosovo.eu

Vërejtje: Zbatimi i këtij programi varet nga mundësia e financimit nga BE, menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë

“Skema e Bursave të BE-së” është projekt i financuar nga BE, menaxhuar nga KE dhe zbatuar nga British Council.